

NJOFTIM

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Per ndryshimin e rendit te ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 26 Maj 2022, sipas kërkesës se paraqitur nga Drejtoria ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 26 Maj 2022 behet si me poshtë:

1. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panënshkruara të emetuara me Vendimin nr. 04/3, datë 01.10.2019 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a.
2. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të "Bankës Credins" sha per vitin 2021 sipas IFRS.
3. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të "Bankës Credins" sha per vitin 2021 sipas kërkesave te Bankes se Shqipërisë.
4. Mbi miratimin e Rezultatit Financiar te "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës se Shqipërisë sh.a per vitin 2021.
5. Mbi miratimin e përdorimit te fitimit të "Bankës Credins" sha per vitin 2021.
6. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me deklarimin e dividendit nga fitimet e vitit 2020.
7. Mbi miratimin e ekspertës kontabël te autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala per vlerësimin e zmadhimit te kapitalit aksioner te shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit te fitimit te pashpërndare te vitit 2021.
8. Propozim per miratimin e emetimit te ri te obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme te Bankes Credins sh.a.
9. Propozim per shitjen e nje pjese te portofolit me probleme te Banka Credins sh.a.
10. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me blerjen e pasurisë se patundshme ne territorin e Kosoves miratuar me Vendimin nr. 06/2, datë 15.05.2020 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a.
11. Mbi miratimin e rritjes se shpërblimit te Këshillit Drejtues te Banka Credins sh.a.
12. Mbi miratimin e dhënies se bonusit per Drejtorinë ne masën 1% dhe per Keshillin Drejtues ne masen 0.5% te rezultatit financiar te vitit ushtrimor sipas BoA.
13. Mbi miratimin e gjetjes se financuesve per zhvillimin e mëtejshëm te objektit të veprimtarisë se fondeve "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK dhe "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
14. Ngarkohet Drejtoria per te gjetur financuesit e mundshëm per zhvillimin e mëtejshëm te objektit të veprimtarisë se fondeve "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK dhe "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.

15. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të "Banka Credins Kosove sh.a", të zhvilluar me date 25.03.2022, me rend dite sa me poshtë:
1. Propozimi për miratim të vendimit për rritjen e kapitalit të "BANKES CREDINS KOSOVË", nëpërmjet emetimit të aksioneve të zakonshme të shoqërisë.
 2. Propozimi për miratim të vendimit për nënshkrimin e aksioneve të reja të zakonshme të emetuara nga "BANKA CREDINS KOSOVË".
 3. Propozimi për miratim të vendimit për plotësim-ndryshim të Statutit të "BANKES CREDINS KOSOVË".
16. Konfirmimi për vendim-marrjen e Banka Credins Shqiperi ne mbledhjet e Asamblesë së "Banka Credins Kosove" të zhvilluara deri me sot dhe caktimi i autoritet dhe kompetencave, për përfaqësimin e Bankes Credins Shqiperi ne të ardhmen, ne lidhje me të gjitha kompetencat që Statuti i Bankes Credins Kosove ja rezervon Asamblesë së Aksionereve.
17. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionareve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si me poshtë:
1. Mbi miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit të pavarur Grant Thornton sh.p.k., të shoqërisë administruese Credins Invest sh.a., të Fondit të Pensionit "Credins Pension", të Fondit të Investimit "Credins Premium", për vitin e mbyllur më 31.12.2021.
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit për vitin e mbyllur më 31.12.2021.
 3. Mbi miratimin e rritjes së shpërblimit për Këshillin e Administrimit.
 4. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
18. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, të zhvilluar me date 15.04.2022, me rend dite sa me poshtë:
1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese Grant Thornton sh.p.k., (ekspert kontabël i miratuar).
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2021.
 3. Mbi njohjen me ndryshimet në Prospektin e Fondit "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, konkretisht seksioni "Tarifat e Fondit"
 4. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
19. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, të zhvilluar me date 15.04.2022, me rend dite sa me poshtë:
1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese Grant Thornton sh.p.k., (ekspert kontabël i miratuar).
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2021.

3. Mbi njohjen me ndryshimet në Prospektin e Fondit "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, konkretisht seksioni "Tarifat e Fondit"
4. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

20. Ngarkohet Drejtoria të beje njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane më 18.05.2022

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.